Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. Br. 303/19
Date/Datum. 24.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit AK: **Kuvendi i Komunës – Kaçanik** Grupi i OE ankues: **N.T.P.SH.Z. " Lypeteni"– Kaçanik**	Kopje	Paneli Shqyrtues – OSHP: **Nr. 303/19**
Prej:	**Sahit Beqiri**– Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me **Nr. 303/19** të parashtruar nga OE: **N.Sh.T. "Lypeteni" –Kaçanik**		
Datë	**24.06.2019**		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën me datën:**11.06.2019** me **Nr. 303/19** të parashtruar nga OE: **N.T.P.SH.Z. " Lypeteni"– Kaçanik,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shitja e masës drusore sipas planit operativ 2019",**me nr. prokurimi: **652-19-043-221,**iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK):**Kuvendi i Komunës – Kaçanik.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues– Kuvendi i Komunës – Kaçanik.*
- *Panelit Shqyrtues– OSHP*
- *OE ankues–N.T.P.SH.Z. " Lypeteni" – Kaçanik*

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I *EKSPERTIT SHQYRTUES*

Beqiriri	**12.06.2019**	**13.06.2019**	**24.06.2019**
Nënshkrimi i ekspertit	Data e autorizimit të ekspertit	Data e fillimit të ekspertizës	Data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: **11.06.2019**OE:**N.T.P.SH.Z. " Lypeteni"– Kaçanik,** ka parashtruar ankesë në OSHP, **kundër njoftimit për anulimin e aktiviteti të prokurimit,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shitja e masës drusore sipas planit operativ 2019",** me nr. prokurimi:**652-19-043-221,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK):**Kuvendi i Komunës – Kaçanik.**

Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit nuk është nxjerr ndonjë njoftim/vendim nga OSHP-ja.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

N.111, LPP - Operatori Ekonomik Ankues:N.T.P.SH.Z. " Lypeteni"– Kaçanik.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues: *N.T.P.SH.Z. " Lypeteni"– Kaçanik*,janë:

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 44.7 i LPP-së

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Te nderuar, ju njoftojmë se autoriteti kontraktues ne këtë aktivitet te prokurimit e ka përgatitur dosjen e tenderit për shitje te aseteve përmes ofrimit publik. Ne dosje te tenderit ka qene e parashikuar qe afati i fundit për dorëzim te ofertave është dt. 08.05.2019 ne ora 14:00 Vendi: përmes E-prokurimit (kjo ka qene e përcaktuar ne nenin 15.1 te FDT-se). Kriter kryesore për dhënie te kontratës ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te lartë.

Me dt. 07.05.2019, një dite para hapjes se ofertave autoriteti kontraktues e ka bere një ndryshim përmirësim ne dosje te tenderit dhe e ka ngarkuar ne E-prokurim, e ndryshimi kishte te bënte me mënyrën e ofertimit. Neni 15.1 i FDT-se është ndryshuar dhe është përcaktuar si ne vijim: "afati i fundit për dorëzim te ofertave është dt. 08.05.2019 ne ora 14:00 vendi: ne zyrën e pritjes **kopjet fizike (origjinali dhe një kopje).**
Pra është ndryshuar mënyra e ofertimit, nga ofertomi përmes E-prokurimit ne mënyrën e dorëzimit te ofertave ne kopje fizike një origjinal dhe një kopje.
Përderisa është bere ky ndryshim dhe nuk është parashikuar qe ofertat mund te dorëzohen me ne E-prokurim, ne kemi ofertuar ne kopje fizike, ashtu siç ka kërkuar autoriteti kontraktues me njoftimin e dt. 07.05.2019. Mirëpo ne për çdo rast kemi dorëzuar ofertën edhe ne mënyrë elektronike me nguti edhe pse sistemi nuk ka punuar si duhet dhe s'kemi qene te obliguar te ofertojmë përmes E-prokurimit.

S.B

Ne kemi ofertuar me çmimin me te larte ne këtë tender/ankand me çmimin prej: 52,048.40 € dhe normalisht i plotësojmë te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit te kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe është dashur te shpallemi fitues.

AK-ja ne letrën standarde për tenderuesin te eliminuar qe na ka dërguar me dt. 27.05.2019, është shënuar se jemi te papërgjegjshëm për këto arsye: deklarata nen betim, licenca stafi, dëshmitë për pajisjet traktor (si dhe neni 34.14 i UOP dorëzimi i dy tenderëve kopje fizike dhe elektronike).

Fillimisht ne nuk e kemi te qartë se ku është marr neni 34.14 dhe cilit legjislacion i është referuar, por nëse i është referuar Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, ky udhëzues nuk përmban nen 34.14.

Po ashtu ju njoftojmë se te gjitha dokumentet për te cilat AK-ja konsideron qe ne nuk i kemi, ne i kemi bashkangjitur ne kopje fizike dhe ato mund te dëshmohen shume lehte, por AK-ja ne mënyrë shume tendencioze na ka eliminuar me arsyet e lartpërmendura dhe duke u bazuar ne dispozitat te cilat ne nuk e dimë se ku i kane gjetur ata.

Pra ne, i kemi me deklaratën nen betim, licencë, me staf, me pajisje etj., dhe jemi ofertuesi i përgjegjshëm duke plotësuar edhe kriterin kryesor për dhënie te kontratës e qe ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te lartë, prandaj është dashur te shpallemi fitues.

Në momentin qe është bere ndryshimi i dosjes dhe është kërkuar qe te ofertojmë me kopje fizike, tek ne është krijuar një huti se cilës dosje ti përmbahemi dhe cili është me i rëndësishëm dhe kemi ardh ne përfundim qe ti kushtojmë rendësi ndryshimit te fundit te dosjes dhe kemi përgatitur te gjitha dokumentet ne kopje fizike te kompletuara dhe i kemi dorëzuar. Ndërsa E-prokurimin e kemi lënë te dorës se dytë, por për çdo rast e kemi dorëzuar ne shpejtësi dhe dosjen ne mënyre elektronike e ne mënyrë elektronike mund te mos jete vetëm deklarata nen betim edhe pse nuk është kërkuar ne ftesën për ofertim. Mirëpo me rastin e vlerësimit te ofertave duhet te merret parasysh oferta fizike sepse ne dosjen me ndryshime është kërkuar kështu dhe këtë ndryshim e kane bere autoriteti kontraktues.

Deklarata nen betim me te gjitha dëshmitë tjera te kërkuara janë ne kopje fizike edhe pse ne ftesën për ofertim për shitje tek kërkesat minimale për kualifikim nuk është kërkuar deklarata nën betim. Prandaj autoriteti kontraktues nuk mund te bene vlerësim te ofertave qe jen dorëzuar ne mënyrë elektronike, por duhet te behet vlerësimi i ofertave qe janë dorëzuar ne kopje fizike.

Përfundimisht autoriteti kontraktues ne këtë aktivitet te prokurimit nuk e ka respektuar nenin 59 te LPP-së sepse na ka eliminuar neve edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate dhe njëkohësisht kemi ofruar çmim me te larte ne krahasim me ofertuesit tjerë, duke e plotësuar edhe kriterin kryesore për dhënie te kontratës e qe ka qenë tender-ankandi me çmimin me te lartë.

Duke u bazuar ne te gjitha sqarimet qe i kemi cekur me larte, rezulton se anulimi i këtij aktiviteti te prokurimit është bere ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-së dhe ne kundërshtim me nenin 44.7 te Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP) **pika (ii),** sepse ne jemi ofertues i përgjegjshëm duke i plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate dhe është dashur te shpallemi fitues.

Gjithashtu ne jemi diskriminuar ne këtë tender-ankand, ne kundërshtim me nenin 7 te LPP-se, sepse aty parashihet qe autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do te veproj ne mënyrë transparente. Ky diskriminim është bere për faktin se ne si kompani i plotësojmë te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate.

Gjithashtu autoriteti kontraktues është dashur te këtë ne konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publik, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktues ne Kosovë.

Autoriteti Kontraktues, me anulimin e këtij aktiviteti janë duke e dëmtuar interesin e përgjithshëm te Komunës sepse nëse ne do te shpallemi fitues me çmimin me te larte qe kemi ofertuar, atëherë inkasomi i mjeteve financiare do te ishte shume me i madh.

Duke u bazuar ne dheshmit dhe faktet qe u ceken me lart, kërkojmë nga OSHP-ja qe te merr:

VENDIM

APROVHET, ankesa e OE NTSH "Lypeteni" si e bazuar dhe lënda te kthehet ne **RIVLERËSIM** dhe gjate rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit , njoftimit për kontrate dhe konform dispozitave te LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucione tjera kompetente.

Pretendimet ankimore tek dispozitat e shkelura nga AK ligjore janëtë njëjtame kërkesën për rishqyrtim pran AK– Kuvendi i Komunës – Kaçanik.

S.B

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë/ **Ftesa për ofertim për shitje**:	19.04.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur/**Ofertave publike të mbyllura**
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	**Shitja e aseteve përmes ofertimit publik**
Vlera e parashikuar e kontratës:	26,840.69 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)	Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të lartë
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave	08.05.2019
Data e hapjes së ofertave	08.05.2019
Data e përfundimit tëvlerësimit të ofertave	27.05.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesin epasuksesshëm	27.05.2019
Data e njoftimit mbi Vendimin e AK - B58	30.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim	03.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim	07.06.2019

Kriteret për vlerësim:

NENI I: EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)
Emri zyrtarë: KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK
Adresa postare: RR "AGIM BAJRAMI" P.N.
Qyteti: KAÇANIK Kodi postarë: -71000 Shteti: Kosovë
Kontakti: Shefket Koxha Telefoni: 0290380922
Email: Shefket.koxha@rks-gov.net Faksi:
Adresa e faqes së internetit (nëse është e aplikueshme):

NENI II: LËNDA E SHITJES
Autoriteti kontraktues ka për qëllim shitjen e **Shitja e mases drusore sipas planit operatvi per vitin 2019.** Përmes ofertave publike të mbyllura.
Shitja e mases drusore sipas planit operatvi per vitin 2019. Shiten në kushte "siç janë, ku janë" dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë përgjegjësitë mëtutjeshme pas shitjes.

NENI III: INFORMATA ADMINISTRATIVE
Autoriteti Kontraktues fton oferta të mbyllura për blerje të **Shitja e mases drusore sipas planit operatvi për vitin 2019, 410.8m3 dru tekni dhe 738.30 m3, dru zjarri**

S.B

Ofertimi është i hapur për të **gjithë ofertuesit e interesuar që përmbushin kërkesat minimale për kualifikim**

1.Çertifikata e regjistrimit të bizbnesit me shifrat e veprimtarisë. 2. Çert. enr. Fiskalë nëse nuk është ne cerrt. e biznesti. 3. Çert. e TVSH-se. 4.Licenca për eksploatimin e pyjeve -valide. 5. Dëshmia nga autoriteti përkatës se nuk është në procedurë te ndjekjes për prerje ilegale te pyjeve. 6. Dëshmi nga autoriteti pyjor komunal se kundër subjektit përkatës nuk ka te ngritur procedurë për dëme pyjore dhe se nuk ka obligime te pa kryera nga kontratat e më parme. 7.Planikdinamik. 8.Njilngjinjerapotekniki pylltarisë me dëshmitë Diploma-kopje, Kontrata e punës, CV). 9.Specifikacioni për Mekanizmin në dispozicion së paku prej -a) traktor për tërheqje se paku nji. b) kamion transportues se paku 2, c)sharra motorike se paku 2. Për automjetet dëshmitë, Libreza e regjistrimit për automjetet që i nënshtrohen regjistrimeve vjetore, -Lista e projekteve dhe kontrata me reference së paku nji të realizuara në tre vjeshin e fundit.

Dokumentet e ofertimit do të kërkohen nga ofertuesit e interesuar duke dorëzuar një aplikacion me shkrim në adresën e cekur më lartë.

Ofertuesit e interesuar mund të inspektojnë **Shitja e mases drusore sipas planit operatvi për vitin 2019, 410.8m3 dru tekni dhe 738.30 m3, dru zjarri** në **Njësia mengjuese Ahishte komuna Kacanik.** Më **25.04.2019** nga **12:00**

Ofertat duhet të dorëzohet në adresën e cekur më lartë jo më vonë se 08.05.2019 & 14:00:00

Ofertat e vonuara do të refuzohen.

Dhënia e kontratës: **Çmim dhe faktorë tjerë**

Dëshmit e kërkuara te kërkesat minimale per kualifikim.

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e përcaktuar ne Nenin I te kësaj Ftese.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vlera e parashikuar	Vërejtje &E-prokurimi
1.	NTSH,,.Dardani "	Kaçanik	42290,00	**26840.69**	JO / E-prokurim elektronik
2.	N.T.SH." BUJARI ",	Viti	44743,00		JO / E-prokurim elektronik
3.	N.P.SH. "Kemi"	Kaçanik	48851,00		JO / E-prokurim elektronik
4.	N.T.P.SH.Z. " Lypeteni "	Kaçanik	52048,40		JO / E-prokurim elektronik& oferta fizike
5.	Ndërmarrja Tregtare " Daja ",	Prishtinë	37569,08		Oferta fizike

S.B

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues:

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- **Agim Luzha**– Kryetar i komisionit (Ekonomist)
- **Rahim Fuga** – Anëtar i komisionit (//////)
- **Remzi Shabni** – Anëtar i komisionit (Ekonomist)

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni Ri-vlerësues ka konstatuar:

D E K L A R A T Ë:

Ne DT kërkohet sigurimi i tenderit mungon nuk ceket shuma dhe afati, ndërsa ne ftesën për tender nuk është kërkuar. (është plotësuar me dore dhe është i palexueshëm/ jo i kuptueshëm)

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues

EMRI I OPERATORËVE EKONOMIK QË KANË DORËZUAR TENDER TE PËRGJEGJSHËM	VENDI	ÇMIMI € (Euro)
///	///	///

- Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, nuk ka rekomanduar asnjë OE, duke e plotësuar me dore formularin e vlerësimi te tenderit, formën fizike (formularin e vjetër kur ka qene pranimi i tenderëve fizik para se te hynte ne fuqi prokurimi elektronik), por ky formular është plotësuar jo si duhet dhe është i pa kuptim.

Menaxheri i prokurimit nuk e ka nënshkruar fare raportin e komisionit të vlerësimit.

***Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: N.T.P.SH.Z. " Lypeteni"*– Kaçanik.**

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur rregullat e LPP-së, konkretisht **neni 1, 7, dhe 59 të LPP-së.**

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam pranuar ne shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit (ne këtë aktivitet te prokurimit), AK nuk ka vepruar ne kundërshtim me nenin **7 paragrafi 2, te LPP-se**, po citoj: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik" **si dhe nuk ka respektuar nenin 59 par. 4 të LPP-së**, po citoj: "A*utoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*

Duke u bazuar ne këto fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam pranuar ne shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit (ne këtë aktivitet te prokurimit) komisioni i Ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit sipas ftese për ofertim për shitje dhe dosjes se tenderit, AK me datën 07.05.2019 ngrit ne platformën elektronike Njoftimin për korrigjim, konkretisht dosjen e tenderit për shitjen e aseteve (duke i ven ne lajthitje OE dhe duke krijuar paqartësi se si te veprohet) ne **nenin 15.1 Afatin për dorëzimin e tenderit është: 08.05.2019 në14:00:00 orë; Vendi: Në zyrën pritjes kopjet fizike (origjinali dhe nji kopje).** (OE ankues ka dorëzuar ofertën ne platformën elektronike si dhe mënyrë fizike. Konsideroj se AK duhet te vlerësoj ofertat e OE ne mënyrë fizike). Prandaj, duke pas parasysh nenet e lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika **janë të qëndrueshëm.**

SoB

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet ne **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikas, me transparent dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve publike. Andaj, AK – Qendra e Studenteve, nuk ka vepruar ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-së.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur rregullat e LPP-së, konkretisht **neni 62 të LPP-së, si dhe nenin 44.7 te RrUOPP.**

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam pranuar ne shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit (ne këtë aktivitet te prokurimit), AK nuk ka vepruar ne pajtim me neni 62 par. 1.1. te LPP-së, po citoj: *"një shkeljeje të ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedure e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit*"

Eksperti shqyrtues sqaron, se AK pas ndryshimeve ne dosjen e tenderit me date 07.05.2019, konkretisht, ne dosjen tenderit për shitjen e aseteve ne **nenin 15.1 Afatin për dorëzimin e tenderit është: 08.05.2019 në 14:00:00 orë; Vendi: Në zyrën pritjes kopjet fizike (origjinali dhe nji kopje),** dhe ngritjes ne platformën elektronike, prandaj për lëshimet te cilat i ka bere autoriteti kontraktues duke e diskriminuar OE ankues ne lidhje me këtë aktivitet te prokurimit, nuk duhet dhe nuk mund te pësojnë operatoret ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit. Pas këtyre ngjarjeve dhe rrethanave te krijuar nga vete AK me ndryshimin ne dosjen e tenderit, AK duhet te vlerësoje tenderët bazuar ne kërkesat dhe dëshmitë ne dosjen e tenderit sipas nenit 59.4 te LPP-së duke respektuar ne tersi dispozitat ligjore te LPP-se.

Prandaj duke pasur parasysh këto fakte i rekomandoj autoriteti kontraktues për këtë aktivitet te prokurimit te merr parasysh edhe rendësin e këtij aktiviteti te shitjes se aseteve për Komunën e Kaçanikut duke mos dëmtuar OE për shkeljet ligjore, gabimet e krijuar nga autoriteti kontraktues, por ti përmirësoj dhe te veproj ne tersi sipas dispozitave ligjore te LPP-se. Pasi ne këtë aktivitet te prokurimit kanë ofertuar 5 operatore ekonomik dhe shkeljet apo gabimet kanë ndodhur nga autoriteti kontraktues jo pse kanë qene jashtë kontrollit te tij, apo te parashikueshme, por nga mos kujdesi apo pakujdesia e AK. Prandaj, në bazë të analizës se mësipërme sqarojë se **pretendimet e palës në këtë ankese janë të qëndrueshme.**

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezentuara në dosjen e tenderit, raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, në ankesa e OE: **N.T.P.SH.Z. " Lypeteni"– Kaçanik,** për tenderin e **AK: Kuvendi i Komunës – Kaçanik,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Shitja e masës drusore sipas planit operativ 2019",** me nr. prokurimi: **652-19-2400-2-6-10 nr. brend. 652-19-043-221,** lidhur me njoftimin për kontratë, rekomandon që ankesa e OE ankues të ***aprovohet si të bazuara***, (*për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr. 1 si më lartë*) dhe të njëjtin tender rekomandojmë autoritetin kontraktues – Panelin Shqyrtues, që ky aktivitet i prokurimit të **Ri-vlerësohet** dhe të veproj në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të LPP-së.

S.B